




1 | Frikë! A mundem ta mbroj fëmion tim nga rreziqet në jetë?

Të gjithë rreziqet nuk mund të shmangen. Në disa situata duhet të kemi besim. Një mbrojtje e mirë është gjithsesi, fëmion ton ta mësojm si tu largohet rreziqeve.



2 | Fëmijët na sjellin në kufijt e durimit tonë!

Është obligimi ynë që gjat zemrimit, të gjejm „një dalje urgjente“ para se P. Sh. ta rrahim fëmion tonë. Është vështirë, të jemi të qetë, kur fëmion ynë është i zemruar. Por zemrimi kalon përsëri. E dobishme është në këtë rast, që të marrim frymë thellë, ose për një kohë të largohemi nga ajo hapësirë.



3 | Dënimi i dobësion fëmijët. Pasojat u japin Orijentim.

Konsekvencat i tregojnë fëmion tonë, se janë pasojë e një sjelljeje të caktuar. Ju nuk e keni qëllimin që ta dënoni ose ofendoni fëmion tuaj. Shembull: „Nëse nuk i përmbahesh orarit, sipas marrveshjes, herën tjetër duhet të rrijsh në shtëpi“.



4 | Eja, do ta bëjë unë shpejt për ty.

Diçka që mundesh vet ta bëjësh të bën krenar dhe të jep vetëbesim. Nëse gjithçka që fëmijët mund ti bëjnë vetë, ua bëjmë ne, ne i marrim ata si të dobët dhe të vegjël.



5 | Përjetimet e përbashkëta pozitive ndihmojnë që ti tejkalojmë krizat.

Aktivitetet e përbashkëta dhe përvojat e mrekullueshme e forcojnë familjen dhe i japin fuqi për kohrat e vështira.



6 | Mos e krahaso kurrë një fëmijë me një fëmijë tjetër, por atë me vetveten!

Nuk ka dy njerëz të njëjtë. Çdo fëmijë ka ritmin e vet, talentin dhe veçoritë e veta, si dhe dobësitë dhe vështirësitë e veta. Krahasimet mund të dekurajojnë dhe helmojnë marrëdhënjet.




7 | Fëmijët e fort (të vendosur) u thajnë „Jo“ jo vetëm të „Huajve“, por edhe në shtëpi.

„Jo“ të thuhet, është sidomos me rëndësi, atëherë kur bëhet fjalë për nevojat dhe kufizimet vetjake (P.Sh. „Jo, tash dua të jem vetëm“). Familja është vendi më i rëndësishëm për ta mësuë këtë.



8 | E qeshura e përbashkët është Balsam për shpirtin.

Nëse momentalisht nuk ka rast për të qeshur: Ndonjëherë ndihmon një film qesharak, të cilin e shikoni bashkarisht.


9 | Për edukatën e një fëmiju nevojitet një fshat i tërë .

Ne nuk duhet patjetër që çdo gjë ta bëjmë vet.

Gjithashtu Prindërit, Gjyshërit dhe kujdestarët tjer mund të marrin obligime në edukim dhe përkujdesje.


10 | Një „Jo“ e qartë është spesh një përgjigje e dashur që duhet të ua japim fëmijëve.

Për zhvillimin e mirë të fëmijëve, ne duhet që shpesh të themi jo:


Për ta mbrojt nga rreziqet /kur është fjala për kohën e shiqimit të televizorit ose kohën e fjetjes / ose për dëshirën e konsumit të tepërt.


11 | Është ndjenjë e mirë të vërejtshë, se dikush interesohet për mua.

Përderisa ne interesohemi sinqerisht si ndjehet fëmiju yn, çka përjeton, çka i pëlqen, çka mendon në lidhje me diçka,... me këte ne i tregojm se jemi të interesuar për të.


12 | Unë të pranoj ty, ashtu siç je.

Është gjë normale që disa veçuri të fëmijut ton nuk na pëlqejn. Përkundrazi ne i duam fëmijët ton. Vetëm një njeri që pranohet nga prindërit e tij, e pranon edhe vetveten.


13 | Një foshnje në shtëpi sjell shumë gëzim dhe shumë punë.

Foshnjët kërkojnë shumë përkujdesje dhe vëmendje. Prandaj është mirë që ndonjëherë të lirohemi nga kjo bar dhe përkujdesjen e foshnjës ta marrin anëtarët tjer të familjes.


14 | Prindërit e fortë nuk kanë nevojë për fëmijë perfekt.

Diçka te provojm dhe me atë rast të bëjmë gabim është çështje normale jetësore. Fëmiju yn ka të drejt të jetë fëmij.


15 | Fëmijët mundën vet ti zgjedhin Konfliktet ndërmjet tyre – nëse i lejojm.

Zgjedhja e konflikteve është një përvojë shumë e rëndësishme.

Të ua japim fëmijëve tan mundësinë që ta mësojnë këte!

Nëse ata vetë nuk ia arrijnë qëllimit ne mundemi me këshilla tu ndihmojmë.


16 | Fëmijët duhet të lejohen ta thonë fjalën e tyre nëse ajo çështje ka të bëjë me ta.

Ne si prindër kemi përgjegjësi në familje.

Mirëpo mvarrsisht prej moshës së fëmijëve në çështje të ndryshme duhet që edhe fëmijët të përfshihen ose të bashkëvendosin.